



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 13 date 25.01.2018

“ PER NDRYSHIMIN E TARIFAVE TE UJIT”

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 date 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore"; ligjin Nr.115/2014 " Per ndarjen administrativo-territorjale te Njesive te Qeverisjes Vendore ne Republiken e Shqiperise", dhe ligjit 9901 , dt.14.04.2016" Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ,VKM nr. 510 date 10.06.2015 "Per miratimin e procedurave per transferimin, e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupezuara, te aktiveve dhe cdo dokumentacioni tjeter zyrtare ne njesite e qeverisjes vendore te prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", VKM nr.63 date 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujerave te ndotura" dhe Vendimit te KB nr. 105 dt. 15.12.2017 , per transferimin e ujerave te ndotura prane SH.A.Ujesjellesit Tropoje dhe krijimin e SH.A.Ujesjelles-Kanalizime Tropoje, Vendimit nr.39 dt.09.12.2015 “ Per miratimin e politikës tarifore per sherbimin e furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujerave te ndotura” , kerkohet Keshillit Bashkiak per ndryshimin e tarifave te ujit mbeshtetur dhe ne studimin e bere nga kjo shoqeri per ndryshimin e ketyre tarifave te ujit pas riorganizimit te kesaj Shoqerie:

VENDOSI:

1. Ndryshimin e tarifës së ujit si më poshtë:

- Tarifat për klientet familjar 41 lek/m³
- Tarifat për klientet private 86 lek/m³
- Tarifat për entet shtetërore 72 lek/m³
- Tarifat për furrat e bukës 49 lek/m³

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tropoje dhe SH.A.Ujesjelles-Kanalizime Tropoje.

3 Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës.

Për Këshillin e Bashkisë Tropoje

Sekretari

Rubin SELLAJ

Kryetari

Ime HOXHA

